

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Shoqatat e Transportit Urban dhe Interurban: Nga nesër, reduktojmë 20-30% të autobusëve – Vizion Plus
ADRESA	https://www.vizionplus.tv/shoqatat-e-transportit-urban-dhe-interurban-nga-neser-reduktoj-me-20-30-te-autobuseve/
BURIMI	vizionplus.tv
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	7 shtator 2026, 05:15:35 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	31 gusht 2026, 08:54:19 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5bb75cf0e4a3ae2d62fcd3c62e9c9bcd6711652dc277d62bf1ba66e1d4886576
TEKSTI	0ff2b518811b5a9e0978cf1d8ca3c10c501354e456bbd59a7c0acd879698bfbdb
PAMJA	58c895829adf17d116d3bd22d7e87088b55081e38b2c98bc6a6125ee4c9fe897

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1a86078d099b6cf5abbb98e9d3fca199cd4369bc49bb20f2e437424d76c7647f
E MËPARSHMJA	befad3fae1a934fe0a7eabafd4a9334e7d54c4bef102d2b095f50faf36ad0d63
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1a86078d099b6cf5abbb98e9d3fca199cd4369bc49bb20f2e437424d76c7647f>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



shtatori do të reduktojnë me 20-30% floten e mjeteve në qarkullim, për shkak të kostove të larta të karburantit.

Në një letër drejtuar Kryeministrit, Bashkisë së Tiranës, Ministrisë së Infrastrukturës dhe asaj të Financave, Shoqata e Transportit Qytetas dhe Shoqata e Transportit Urban dhe Interurban thonë se operatorët e transportit publik nuk mund të përballojnë më kostot për të operuar me kapacitet të plotë.

Sipas tyre, pavarësisht kërkesave të vazhdueshme për kompensimin e kostove të karburantit, deri tani nuk është dhënë një zgjidhje konkrete.

Letra e plotë:

Shoqata Kombëtare e Transportit Qytetas dhe Shoqata e Transportit Urban dhe Interurban, në përfaqësim të operatorëve të transportit publik, ju bëjnë me dije se situata financiare e operatorëve ka arritur në një nivel tejet të vështirë, duke ndikuar drejtpërdrejt në mundësinë e tyre për të vijuar ofrimin e shërbimit me kapacitet të plotë.

Pavarësisht kërkesave dhe komunikimeve të vazhdueshme të adresuara pranë institucioneve përgjegjëse lidhur me kompensimin e kostove të karburantit, operatorët vijnë të përballen me mosrealizimin e kompensimit, ndërkohë që për një pjesë të kërkesave dhe problematikave të ngritura nuk është dhënë ende një përgjigje apo një zgjidhje konkrete institucionale. Kjo situatë, e kombinuar me nivelin e lartë të kostos së karburantit dhe shpenzimet e tjera të domosdoshme për funksionimin e aktivitetit, ka cenuar ndjeshëm likuiditetin financiar të operatorëve dhe

5 Elbasani nuk tanëgnatipeson humbjen e parë të sezonit

NEWSLETTER

Përmbledhja e ditës në e-mail

Abonohu

mundësinë e tyre për të përballuar kostot ditore të operimit të të gjithë flotës së mjeteve.

Për këtë arsye, njoftojmë se duke filluar nga data 01.09.2026, operatorët e transportit publik do të detyrohen të operojnë me një flotë të reduktuar në masën rreth 20-30%, në varësi të kapacitetit financiar dhe operacional që secili operator ka aktualisht në dispozicion. Masa e reduktimit nuk përbën një zgjedhje të operatorëve dhe as një mungesë vullneti për garantimin e shërbimit normal të transportit publik. Ajo është një pasojë e drejtpërdrejtë e pamundësisë financiare për të mbuluar kostot e operimit me flotë të plotë, sidomos kostot e karburantit, të cilat përbëjnë një nga zërat kryesorë të aktivitetit. Reduktimi i mjeteve në qarkullim pritet të sjellë në mënyrë të pashmangshme ulje të frekuencës së shërbimit, rritje të intervaleve ndërmjet mjeteve, mbingarkesë të mjeteve që do të mbeten në qarkullim dhe vështirësi për qytetarët që përdorin çdo ditë transportin publik.

Në këto kushte, u kërkojmë institucioneve përgjegjëse që të ndërhyjnë me urgjencë, të japin një përgjigje konkrete mbi kërkesat e paraqitura nga operatorët dhe të mundësojnë realizimin e kompensimit të parashikuar për kostot e karburantit, si dhe vijimin e mbështetjes për periudhën në vazhdim. Operatorët kanë bërë dhe vijojnë të bëjnë çdo përpjekje për të garantuar vazhdimësinë e shërbimit, por në kushtet aktuale financiare operimi me 100% të flotës nuk është më i përballueshëm. Për sa më lart, kërkojmë trajtimin me prioritet dhe urgjencë të kësaj situatë, me qëllim shmangien e përkeqësimit të mëtejshëm të shërbimit të transportit publik dhe rikthimin sa më parë të kapacitetit të plotë operacional.



Redaksia Web

Gazetar/e · Vizion Plus · Redaksia e Vizion Plus.

Të gjithë artikujt

Vazhdo të lexosh



EKONOMI

Nafta "kapërcen" 230 lekë për litër,...

Xhuljana Zhuleku · 42 minuta më parë



EKONOMI

Kërkohet më shumë kredi për shtëpi,...

Xhuljana Zhuleku · Dje 17:01



EKONOMI

Nisma e qeverisë për strehimin social,...

Taulant Halili · 11 Sht



Vizion Plus është një nga televizionet kryesore kombëtare në Shqipëri — lajme, programe, seriale dhe sport, drejtpërdrejt dhe on demand, 24 orë në ditë, kudo që je.

LIVE



Lajme

Politikë
Bota
Vendi
Kronikë
Lifestyle

Programe

Programe
Seriale
Guida TV
Video
Ekipi i Vizion Plus

Rrjeti

Rreth nesh
Karriera
Kontakt
Reklamo me ne
Dërgo lajmin tënd

Ligjore

Kushtet e përdorimit
Privatësia
Cookies
Politika editoriale



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.